

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 27 JANAR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po diskutojmë për një çështje, që shpeshherë ka fatin e trajtimit rutinor parlamentar. E konsiderojmë si një fakt të dhënë mbështetjen nga Bashkimi Europian, në një kohë që duhet të shndërrohej në një debat esencial në lidhje me atë që është në thelb të ekuacionit të marrëdhënieve Shqipëri – Bashkimi Europian, që nuk është gjë tjetër veçse anëtarësimi me të drejta të barabarta i vendit tonë në Bashkimin Europian. Cila është marrëdhënia e kësaj qeverie në këtë ekuacion? Për të nëntin vit që është në pushtet nuk ka shënuar asnjë gjysmë hapi në lidhje me avancimin e statusit të marrëdhënieve tona me Bashkimin Europian. Në qershor të vitit 2014 u konfirmua miratimi i statusit të vendit kandidat, i cili atëherë vetëm de facto u komunikua, sepse vendimi ishte marrë më përpara, por për shkak të zhvillimit të zgjedhjeve u komunikua në atë moment politik. Prej 9 vjetësh jemi në vendnumëro, në mos në disa aspekte jemi duke bërë një hap para dhe dy hapa mbrapa. Me të drejtë shtrohet pyetja, a nuk preket sedra politike e një maxhorance fiktive parlamentare nga ky dështim me objektivin e tyre strategjik? A nuk duhet të ketë një reflektim? Jo, zotërinj, nuk mund të pritet. Ju kolegë të opozitës, e di, e keni të qartë se nuk duhet pasur një iluzion të tillë, por keqardhja ime është për kolegët e krahut të majtë, se si bëhen mbështetës të një politike të tillë, e cila nuk është se thjesht dhe vetëm neglizhon çështjen e anëtarësimit, por kohët e fundit nuk heziton as të shprehet publikisht.

Javën e kaluar Kryeministri i vendit u pyet: cilat janë prioritare për të marrëdhëniet me Republikën e Turqisë apo me Bashkimin Europian? Ai ishte më se i qartë, nuk foli thjesht, por e bërtiti me zë të lartë: “Turqia është një mik i ngushtë, ndërsa Bashkimi Europian është një aleat strategjik”. Pse për këtë populli shqiptar, qytetarët e këtij vendi, klasa politike shprehen në mënyrë dërrmuese në favor të Bashkimit Europian, që Kryeministri i vendit t’i rezervojë Bashkimit Europian statusin e partnerit strategjik, të aleatit strategjik? Zotërinj, për këtë debatojmë, për këtë vendosim, për këtë reformojmë vendin, që të bëhemi një aleat strategjik i Bashkimit Europian, apo për t’u bërë një anëtar i barabartë, si të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Europian? A e dëgjoni kryetarin tuaj? Zonja ministre dhe zotërinj ministra a e dëgjoni Kryeministrin tuaj? Po, sigurisht që e dëgjoni, por nuk mund të reagoni, sepse show ynë politik është i prerë dhe i qepur në përmasat e një individi. Duke u nisur nga ky fakt dhe nga kjo konferencë shtypi e përbashkët me Presidentin Erdogan, mos vallë Kryeministri Rama dëshiron që t’i rezervojë vendit tonë fatin që kanë negociatat e Republikës së Turqisë me Bashkimin Europian? Në vitin 2005 janë hapur zyrtarisht negociatat, 17 vjet më përpara, deri tani nga 35 kapituj, janë hapur vetëm 16 dhe është mbyllur vetëm 1. Që nga viti 2016 kemi “dead lock”. Ky është fati që do t’i rezervojë qytetarit të këtij vendi, i cili e ka si prioritetin e prioritetëve, në një kohë që ndihet si evropian, të trajtohet edhe si barabartë me gjithë evropianët e tjerë?

Prandaj, zotërinj, është një investim i kotë i gjithë debatit dhe aq më tepër shpresa se kjo qeveri, ky Kryeministër, mund të punojë me vullnet për të integruar vendin në Bashkimin Europian. Çështja e dytë që dua të trajtoj është se këto fonde në kuadrin IPA II, mes të tjerave si sektor prioritar financimi kanë demokracinë, shtetin e të drejtës dhe të drejtat e njeriut. Me të vërtetë mendojmë se mund të jetojmë në një demokraci parlamentare, në një shtet të së drejtës? Tani jemi në fazën e Këshillimit

Kombëtar. Për perandorin nuk ka institucione, nuk ka Kuvend, nuk ka deputet, parlamentarizmin e dimë se sa prioritete ka pasur gjatë gjithë jetës së tij politike. Nga këndvështrimi i kundërt, vetëm për ta rrënuar atë, por edhe nga ana e qeverisë komunikon perandori me plebisht, askush tjetër nuk ndërhyr në këtë komunikim. Një herë quhet konsultim, një herë quhet këshillim, një herë quhet kuvendim, rezultati është i njëjtë. Autokrati në dimensionet e veta ideale, për t'u admiruar nga të gjithë autokratët e kontinenteve të tjera se në Europë, vetëm me Lukashenkon mund të krahasohet. Shikoni se çfarë po ndodh ditët e fundit! Eksplorojnë se cilat domene të jetës publike janë ende jashtë kontrollit të tyre. Konstatuan se ishte federata. Iu vërsulën federatës. Kemi deklaratat politike; pas deklaratave politike vërsulen tatimet dhe, pas tyre, ndoshta një ko incidencë e zezë, vepron dhe krimi. Janë të ndërlidhura në një shoqëri ku edhe krimi shikon se si nëpërkëmbet e drejta, procedura, se si vihen në shënjestër të interesave të fshehta organizimet publike dhe nuk heziton të përfitojë. Zonja dhe zotërinj, Duke iu drejtuar vetes dhe kolegëve të tjerë të opozitës, konkludoj me një fabul të Ezopit, atë të kalit, drerit dhe gjahtarit. Kemi humbur një betejë, kolegë opozitarë, për momentin nuk përbëjmë shpresën dhe alternativën ndaj kësaj të keqeje, që ka zënë vendin dhe shoqërinë, por të mos bëjmë gabimin e kalit, që, në sherrin me drerin, i besoi gjahtarit fatin e betejës, sepse atëherë kapistalli që do të na vihet do të jetë si ai i kalit, nuk do të jetë i përkohshëm, por afatmesëm dhe afatgjatë, me pasoja edhe më të rënda se ajo që po shkakton politika e autokratit të Tiranës. Zonja dhe zotërinj, Janë situata politike vërtet të rënda; janë situata që meritojnë përcaktimin e "stuhisë perfekte", veçse të mos harrojmë se agimi fillon në momentin kur terri është më i errët. Ju faleminderit!